

1084  
07.11.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

MMA Prot.

Tiranë, më 07.11. 2016

**LËNDA:** SQARIM PËR NIVELET DHE TESTET E GJUHËVE TË HUAJA

**DREJTUAR:** Universiteti i Tiranës;  
Universiteti Politeknik i Tiranës;  
Universiteti Bujqësor i Tiranës;  
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë;  
Universiteti i Arteve, Tiranë;  
Universiteti i Sporteve i Tiranës;  
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër;  
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës;  
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan;  
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë;  
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë;  
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë;  
Qendra e Studimeve Albanologjike;  
Akademia FORCAVE TË ARMATOSURA;  
Akademia e SIGURISË ;  
Universiteti i New York-ut në Tiranë  
SHLUJ "Luarasi"  
Universiteti privat "Albanian University"  
Universiteti katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"  
SHLUJ "Marubi"  
SHLUJ "Universiteti "Marin Barleti"  
Universiteti European i Tiranës  
SHLUP "Wisdom University"  
Universiteti "Aldent"  
Rruga e Dibrës, nr. 235;  
Universiteti Polis  
Universiteti privat "Epoka"  
IALP "Shkolla e Lartë "Nehemia GATEWAY"

Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë  
ShPAL "Pavarësia", Vlorë  
SHLP "Logos"  
SHPAL "Universiteti Metropolitan Tirana"  
SHLP "Tirana Business University"  
SHLP "Hëna e plotë" (Bedër)  
Akademia e studimeve të aplikuara "Reald"  
Akademia Profesionale e Biznesit  
SHLUP "Instituti Kanadez i Teknologjisë"  
institucioni I arsimit të lartë privat "Kolegji profesional i Tiranës"  
Kolegjit Profesional Privat "Ivoçlar Vivadent & Partners"  
SHLUJ "Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi"

Të nderuar rektorë,

Në zbatim të Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë", Ministria e Arsimit dhe Sportit ka nënshkruar dy marrëveshje me Shoqërinë Tregtare "S. T. A." shpk, për ofrimin nga kjo shoqëri të testeve të njohura ndërkombëtarisht:

<b>TOEFL (ITP)</b> ( <i>Test of English as a Foreign Language</i> )	– Gjuha Angleze
<b>TOEIC</b> ( <i>Test of English for International Communications</i> )	– Gjuha Angleze
<b>TFI</b> ( <i>Test de Français International</i> )	– Gjuha Frënge

Duke marrë shkas nga njoftimi i Emisionit Investigativ "STOP"

(<https://www.youtube.com/watch?v=RHYEHGm3COA>), ju bëjmë me dije që sipas Udhëzimit 52, datë (3/12/2015), të MAS (tabela bashkëngjitur udhëzimit), i vetmi test i ofruar në Shqipëri nga subjekti S.T.A është **TOEFL ITP**, për nivelet B1, B2 dhe C1 dhe jo thjesht **TOEFL**.

Gjithashtu, Ju bëjmë me dije se Ministria e Arsimit ka nënshkruar marrëveshje, për ofrimin e testeve të gjuhëve të huaja, të njohura ndërkombëtarisht, me subjektet si më poshtë:

- "Aleanca Franceze e Tiranës", për ofrimin e testeve të njohura ndërkombëtare të gjuhës Frënge: DELF/DALF dhe TCF (*test i njohjes së frëngjishtes*);

- “British Council-Dega Shqipëri”, për ofrimin e testeve të njohura ndërkombëtare të gjuhës angleze për APTIS B1, APTIS B2 DHE APTIS C;
- “English Cultural Institute sh.p.k, për ofrimin e testeve të njohura ndërkombëtare të gjuhës angleze për Cambridge PET, FCE dhe CAE;


Në vazhdimësi, për cdo marrëveshje të re që do të lidhet, në zbatim të Udhëzimit të sipërpërmendur, Ministria e Arsimit dhe Sportit, do t’ju vërë në dijeni rast pas rasti.

Ju lutemi, merrni në konsideratë sqarimin e mësipërm, pasi të gjitha IAL-të do të jenë subjekt i inspektimit të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantët në programet Master dhe Doktoraturë.

Për çdo paqartësi, referojuni Tabelës së Udhëzimit 52 të MAS dhe Marrëveshjeve të lidhura midis MAS dhe Subjekteve që ofrojnë testimet e gjuhëve të huaja:

(<http://www.arsimi.gov.al/al/arsimi/universiteti/marreveshjet-e-nenshkruara-nga-mas-me-subjektet-ofruese-te-testeve-per-gjuhet-e-huaja>)

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,



Juelt



587  
21.06.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

6206  
Nr. .../Prot.

Tiranë, më 16.06.2016  
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: PËRCILLEN MARRËVESHJE

DREJTUAR: UNIVERSITETI I TIRANËS  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
UNIVERSITETI I ARTEVE, TIRANË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS  
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN  
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
QËNDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
AKADEMIA FORGAVE TË ARMATOSURJA  
AKADEMIA E SIGURISË  
  
UNIVERSITETI NEW YORK-UT NË TIRANË  
RRUGA "MEDAR SHTYLLA" (ISH "KOMUNA E PARISIT") NR. 35 - 2301  
TIRANË

SHLUJ "LUARASI"  
RRUGA "DRITAN HOXHA", ISH GODINA E DELEGACIONIT TË KE  
TIRANË

UNIVERSITETI PRIVAT "ALBANIAN UNIVERSITY"  
BULEVARDI ZOGU I  
TIRANË

UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"  
RRUGA E DURRËSIT, KOMPLEKSI SPITALOR UNIVERSITAR  
TIRANË

SHLUJ "MARUBI"  
RRUGA "ALEKSANDËR MOISIU" NR. 76, 1005

SHLUJ "UNIVERSITETI "MARIN BARLETI"  
RRUGA "SAMI FRASHËRI" NR. 41  
TIRANË

AKADEMIA PROFESIONALE E BIZNESIT  
RRUGA "VANGJEL NOTI", NR. 25 (PËRBALLË "AMC"), LAPRAKË  
TIRANË

PLI NR. 100/2015 (MARRËSHITJE) DHE NR. 100/2015

INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË PRIVAT "KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS"  
NJËSIA BASHKIAKE, NR. 4, RRUGA "XHANFIZE KEKO"  
KOMPLEKSI "XHURA"  
TIRANË

KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT "IVOCLAR VIVADENT & PARTNERS"  
RRUGA "PROKOP MYZEQARI", PALLATI MANTOVANI, KATI I  
TIRANË

SHKOLLA E LARTË PRIVATE "JUSTICIA"  
RRUGA BUDI, NR. 74/1, ISH GODINA E NATO-S,  
TIRANË

SHLUJ "SEVASTI DHE PARASHQEVI QIRIAZI"  
KODËR KAMËZ,  
TIRANË

*Të nderuar rektorë,*


Në zbatim të Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë", Ministria e Arsimit dhe Sportit ka nënshkruar dy marrëveshje me:

1. "English Cultural Institute" sh.p.k, për ofrimin e testeve të njohur ndërkombëtarisht të gjuhës angleze "Cambridge", në territorin e Republikës së Shqipërisë, "Cambridge" PET, FCE dhe CAE marrëveshje të cilën e gjeni bashkëlidhur shkresës.
2. British Council, për ofrimin e testeve të njohur ndërkombëtarisht të gjuhës angleze "APTIS", në territorin e Republikës së Shqipërisë, për nivelet B1, B2 dhe C1, marrëveshje të cilën e gjeni bashkëlidhur shkresës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PLARENT NËRECA

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

MO.308. Prot.

Tiranë, më 03.12.2015

UDHËZIM

Nr. 52, datë 03.12.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE  
NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT  
TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 76 dhe pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë,

**UDHËZOJ:**


1. Përcaktimin e niveleve dhe testeve ndërkombëtare të 5 (pesë) gjuhëve të huaja, përkatësisht, Gjuhës Angleze, Gjuhës Frënge, Gjuhës Gjermane, Gjuhës Italiane dhe Gjuhës Spanjolle. Kandidatët, të cilët aplikojnë për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionet e arsimit të lartë, duhet të kenë nivel të njohjes së njëjës prej gjuhëve të huaja, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.
2. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve, bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij udhëzimi në referencë të pikëve të testeve të ndryshme ndërkombëtare dhe shërben si standard për njohjen e gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare përkatëse në Shqipëri.
3. Për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, ndërmjet nivelit **B1** dhe nivelit **C1**. Institucionet e Arsimit të Lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre nivelin e gjuhës, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë, brenda niveleve të sipërcituara në këtë pikë të udhëzimit. Për pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, të nivelit **C1**.
4. Kandidati që aplikon për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në Institucionin e Arsimit të Lartë, duhet të ketë certifikime dhe rezultate të testeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve, të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se 2 (dy) vjet nga momenti i lëshimit të tyre.

5. Dokumenti i njohjes së gjuhëve, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare.
6. Institucionet e Arsimit të Lartë duhet të shpallin në faqen zyrtare dhe ambientet e tyre:
  - a) listën e niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare në referencë të përcaktimeve të Tabelës 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi, të përcaktuar si kriter pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë në atë institucion;
  - b) listën e subjekteve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare.
7. Institucionet e Arsimit të Lartë duhet të garantojnë akses dhe mundësi të barabarta për të gjitha subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare dhe certifikimin të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
8. Institucionet e Arsimit të Lartë, përcaktojnë në rregulloret e tyre, modalitetet e dorëzimit dhe verifikimit të certifikimit të nivelit të njohjes së gjuhës së huaj, në përputhje me procedurat e tjera të pranimin të kandidatit në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.
9. Subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, certifikimet e të cilëve do të shërbejnë në përmbushjen e detyrimit ligjor, duhet të:
  - a) paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentacionin ligjor për të drejtën e pronësisë intelektuale dhe ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave dhe afateve kohore të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
  - b) nënshkruajnë marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me qëllim njohjen e të drejtës së subjektit për ofrimin e testeve, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, shkëmbimin e informacionit në lidhje me testimet ndërkombëtare, si dhe ofrimin e të dhënave për të gjithë kandidatët që aplikojnë në Institucionet e Arsimit të Lartë për programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë;
10. Subjektet që ofrojnë kurse përgatitore, për prodhimin ose/ dhe shpërndarjen e teksteve didaktike të gjuhëve të huaja, nuk mund të jenë ofruese të shërbimit të testeve dhe certifikimeve ndërkombëtare.
11. Studentët e regjistruar në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë, të cilët nuk i janë nënshtruar testimit të gjuhës angleze, si dhe nuk kanë paraqitur dokumentacion pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas Udhëzimit Nr.14, datë 28.3.2011 "Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë", kryejnë testimin sipas këtij udhëzimi.

12. Udhëzimi i Ministrit të MASH Nr.14, datë 28.3.2011 "Për njohjen e testimeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë", shfuqizohet.
13. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

  
MINISTËR





**Tabela 1**

Në mbështetje të Kuadrit të Referencave për Gjuhët të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, njëj testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

Niveli	B1	B2	C1
<i>Gjuha angleze</i>			
<b>Cambridge</b>	<b>PET</b>	<b>FCE</b>	<b>CAE</b>
<b>IELTS</b>	<b>4.0 / 5.0</b>	<b>5.5 / 6.0</b>	<b>6.5 / 7.0</b>
<b>TOEFL Internet-based Test (iBT)</b>	<b>57/86</b>	<b>87/109</b>	<b>110/120</b>
<b>TOEFL Paper-based Test (ITP)</b>	<b>460</b>	<b>543</b>	<b>627</b>
<b>TOEIC</b>	<b>381 / 649</b>	<b>650/ 785</b>	<b>786 / 935</b>
<b>GESE</b>	<b>-</b>	<b>7, 8, 9</b>	<b>10, 11</b>
<b>APTIS</b>	<b>Aptis B1</b>	<b>Aptis B2</b>	<b>Aptis C</b>
<i>Gjuha gjermane</i>			
<b>Goethe-Institut</b>	<b>ZD</b>	<b>ZDFB</b>	<b>ZMP</b>
<b>TestDaF</b>	<b>-</b>	<b>TDN 3 - TDN4</b>	<b>TDN 5</b>
<i>Gjuha franceze</i>			
<b>TFI</b>	<b>345/604</b>	<b>605/824</b>	<b>825</b>
<b>DELFB</b>	<b>DELFB1</b>	<b>DELFB2</b>	<b>DALFC1</b>
<b>TCF</b>	<b>TCF 300 - 399</b>	<b>TCF 400 - 499</b>	<b>TCF 500 - 599</b>
<b>TEF</b>	<b>TEF 361-540</b>	<b>TEF 541-698</b>	<b>TEF 699-833</b>
<i>Gjuha italiane</i>			
<b>Peruggia</b>	<b>CELI2 livello2</b>	<b>CELI3 livello3</b>	<b>CELI4 livello4</b>
<b>Sienna</b>	<b>CILS uno B1</b>	<b>CILS 2</b>	<b>CILS 3</b>
<i>Gjuha spanjolle</i>			
<b>DELE</b>	<b>DELE inicial</b>	<b>DELE intermedio</b>	<b>DELE superior</b>